



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 2360 / prot.

Elbasan, më 31.10.2025

VENDIM

Nr. 67, datë 31.10.2025

"PËR

**SHPALLJEN E PROCESIT TË APLIKIMEVE PËR NJË ANËTAR PËRFAQËSUES TË
FAKULTETIT TË BIZNESIT DHE TË DREJTËSISË NË KOMISIONIN E APELIMIT NË
UNIVERSITETIN E ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutin dhe Rregulloren e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Senati Akademik,

Vendosi:

1. Të shpallë hapjen e procesit të aplikimeve për një anëtar përfaqësues të Fakultetit të Biznesit dhe të Drejtësisë, në Komisionin e Apelimit (KA).
2. Të drejtën për të aplikuar për anëtar përfaqësues të Fakultetit të Biznesit dhe të Drejtësisë, në Komisionin e Apelimit e kanë individët që plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Janë personel akademik me kohë të plotë në Fakultetin e Biznesit dhe të Drejtësisë;
 - b) Kanë përvojë pune në mësimdhënie, jo më pak se 5 vjet, me kohë të plotë;
 - c) Nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
3. Afati i fundit i dorëzimit të dokumenteve për aplikim për anëtar i KA në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", do të jetë data 06.11.2025.
4. Të interesuarit duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së protokollit të Universitetit, brenda datës 06.11.2025 kërkesën për vetëkandidim si dhe një deklaratë për gjendjen gjyqësore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Univesitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

KRYETARI

Prof.Dr. Elvira Fetahu

